



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SKRAPAR
NDËRMARRJA E SHËRBIMIT PYJOR

PROJEKT-VENDIM

Nr. 1 datë 09/12/2025

**“PËR DHËNIEN E DAKORDËSISË PËR VIJIMIN E PROCEDURËS SË HEQJES
NGA FONDI PYJOR/KULLOSOR TË SIPËRFAQES PREJ 3.6 HA, EKONOMIA
KULLOSORE “TOMORRICË”, SIPËRFAQES PREJ 6.1 HA EKONOMIA PYJORE
DËVRI –TËRROVË NË TOTAL 9.7 HA NË PRONËSI PUBLIKE, QË KËRKOHET
NGA SHOQËRIA “VËLLEZRIT HAZISLLARI & QAMO” SHPK, PËR ZHVILLIMIN
E AKTIVITETIT MINERAR NË OBJEKTIN MËLOVË”**

Grupi i punës i ngritur me urdhër të Kryetarit të Bashkisë Nr.555, datë 25. 11. 2025, në zbatim të Ligjit Nr.139/2015 “Per vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, neni 8 pika 2, neni 9 pika 1, nënpika 1.1, germa “b”, nënpika 1.2, neni 27 pika 5, neni 54, germa “e”, Ligjit Nr. 57/2020 “Per Pyjet”, Ligjit Nr. 9693/2007, “Per fondin kullosor” i ndryshuar, VKM- së Nr.433, datë 08.06.2016, “Per transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe të kullotave Publike sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit dhe të ish Komunave/Bashkive” i nryshuar, VKM- në Nr. 888 datë 08.06.2016 “Per rastet e dhënies në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit, procedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve dhe pakësimin në volum nga fondi pyjor kombëtar apo zgjerimin e tyre”, VKM –në Nr. 267, datë 27.04.2023, “Per disa ndryshime në VKM- në Nr. 559, datë 29. 07. 2022 “Per përcaktimin e çmimit dhe tarifave per dhënie në shfrytëzim/ përdorim të fondit pyjor kombëtar për veprimtari ekonomike, si dhe prodhimet drusore dhe jodrusore Pyjore”, Udhëzimin Nr. 1, datë 09.06.2016, “Per rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik”, si dhe shkresën Nr.1283 Prot. datë 18. 11. 2025, me lëndë: Mbi përgatitjen e raportit teknik dhe dhënie e dakordësisë me Vendim të Këshillit Bashkiak” drejtuar Bashkisë Skrapar, përgatiti Raportin Teknik

PROPOZON:

1. Dhënie e dakordësisë për vijimin e procedurës së heqjes nga fondi pyjor/kullosor të sipërfaqes prej 3.6 ha Ekonomia Kullosore “Tomorricë”, sipërfaqes prej 6.1 ha Ekonomia Pyjore Dëvri –Tërrovë, në total 9.7 ha, në pronësi publike, që kërkohet nga shoqëria “Vëllezrit Hazisllari & Qamo” Shpk, për zhvillimin e aktivitetit minerar në objektin Mëlovë.

Grupi i punës:

Besnik Demko

Hajredin Bakiasi

Hava Nuellari